



Bibël për fëmijët
Prezanton

Kur Perëndia Bëri
Gjithçka



Shkruar nga: E. Duncan Hughes

Ilustruar nga: Byron Unger; Lazarus

Adaptuar nga: Bob Davies; Tammy S.

Përkthyer nga: Elida Stoesz

Prodhuar nga: Bible for Children
www.M1914.org

©2008 Bible for Children, Inc.


E drejta e kopjimit: Mund të bëni kopje ose ta shtypni këtë histori,
nëse nuk do ta shitni.



Kush na krijoi ne? Bibla, Fjala e Perëndisë na tregon se si njerëzimi u krijua. Shumë kohë më parë Perëndia krijoi njeriun e parë dhe e quajti atë Adam. Perëndia e krijoi Adamin nga pluhuri I tokës. Kur Perëndia fryu jetë në Adamin, ai u gjallërua. Ai e gjeti vetën e tij në një kopsht të bukur të quajtur Eden.



Para se Perëndia ta krijonte Adamin, Ai krijoi një botë të mbushur me gjëra të bukura. Pak nga pak Perëndia krijoi vende me kodra dhe fusha, lule me erëra të këndshme dhe pemë të gjata, zogj me pendla dhe bleta të zhurmshme, balena rrotulluese dhe kërmijë të rrëshqitshëm.



Në fakt Perëndia krijoi gjithçka që ekziston - gjithçka.

Në fillim, para se
Perëndia t'i krijonte
gjërat, nuk ka pasë asnjë
gjë përveq Perëndisë.
S'ka pasë asnjë njeri,
asnjë vend dhe
asnjë gjë. Asgjë.
S'ka pasë dritë e as
errësirë. S'ka pasë
as lart e as poshtë.
S'ka pasë dje ose nesër.
Ka qenë vetëm Perëndia
që nuk ka fillim. Pastaj
Perëndia filloi punën.




Në fillim,
Perëndia krijoi
qiejt dhe tokën.



Toka ishte pa trajtë
dhe e zbrastë.



Errësira mbulonte
sipërfaqen e
humnerës.

Pastaj
Perëndia
tha. "Le
të bëhet
dritë."




Dhe drita u bë. Perëndia e quajti dritën Ditë dhe
errësirën Natë.

Kështu erdhi mbrëmja e pastaj erdhi
mëngjesi: dita e pare.





Ditën e dytë, Perëndia I vendosi ujërat e oqeaneve, detërave dhe liqejeve në vendin e tyre nën Qiell. Në ditën e tretë, Perëndia tha, "Le të shfaqet toka e thatë." Dhe u shfaq.



Perëndia gjithashtu urdhëroi barin, lulet, shkurrat
dhe drunjtë të shfaqen. Dhe ata u
shfaqën. Erdhi mbrëmja dhe
mëngjesi: dita e tretë.




Pastaj Perëndia krijoi diellin
dhe hënën dhe shumë yje që
askush nuk mund t'i numëroi.
Erdhi mbrëmja dhe mëngjesi:
dita e katërt.



Krijesat e detit, peshqit dhe zogjtë ishin ne radhë ne listen e Perëndisë. Në ditën e pestë Ai krijoi peshkun-shpatë të madh dhe sardelet e vogla, strucin këmbgjatë dhe kolibrat e lumtur. Perëndia krijoi çdo lloj të peshkut që të mbushnin ujërat e tokës dhe çdo lloj të zogjëve të kënaqin tokën, detin dhe qiellin. Erdhi mbrëmja dhe mëngjesi: dita e pestë.



Ai tha, "Të prodhoj toka qenie të gjalla..." Çdo lloj I kafshëve, insekteve dhe rreshqanorëve u krijuan. Aty ishin elefantët që dridhnin token dhe kastorët punëtor. Majmunët trazovaq dhe krokodilët e ngathët. Krimba të dredhur dhe ketra. Gjirafa qafëgjata dhe mace. Çdo lloj i kafshëve u krijua atë ditë.



Erdhi mbrëmja dhe
mëngjesi: dita e gjashtë.



Perëndia krijoi edhe diçka tjetër - diçka shumë të veçantë. Gjithçka ishte tani gati për Njeriun. Kishte ushqim në fusha dhe kafshë për t'i shërbyer atij. Dhe Perëndia tha, "Ta bëjmë njeriun sipas shëmbëlltyrës Sonë. Le që ai të jetë mbi gjithçka në tokë."

KËSHTU PERËNDIA
KRIJOI NJERIUN NË
PAMJEN E TIJ; NË
SHËMBËLLTYRËN E
PERËNDISË AI E
KRIJOI ATË...



Perëndia i tha
Adamit. "Ha
çdo gjë që ti
dëshiron nga
kopshti. Por
mos ha nga pema
e njohjes së
mirës dhe dhe
së keqës. Nëse
do të hash nga
ajo pemë ti do
të vdesësh me
siguri."



Dhe Zoti Perëndia tha, "Nuk është mire për njeriun të jetë vetë. Unë do t'i bëj një ndihmës për të." Perëndia solli gjithë zogjtë dhe kafshë tek Adami.

Adami u vuri emra të gjithve. Ai duhet të ketë qenë shumë i mençur për të bërë këtë. Nga gjithë ata zogj dhe kafshë nuk u gjetë asnjë ndihmës për Adamin.



Perëndia e vuri
Adamin ne gjumë
shumë të thellë.

Hoqi një nga
brinjtë e njeriut
të fjetur, dhe
Perëndia formoi
Gruan nga brinja e
Adamit. Gruan që
Perëndia e krijoi
ishte taman
ndihmësja për
Adamin.



Perëndia gjithçka krijoi për gjashtë ditë.
Pastaj Perëndia bekoj ditën e shtatë dhe
e bëri ditë pushimi. Në kopshtin e Edenit,
Adami dhe Eva gruaja e tij ishin të lumtur
duke iu bindur Perëndisë. Perëndia ishte
Zoti i tyre, Kujdestari i tyre dhe
Shoku i tyre.



Kur Perëndia Bëri Gjithçka

Një tregim nga Fjala e Perëndisë, Bibla

e marrë nga

Zanafilla 1-2

"Zbulimi i fjalëve të tua ndriçon dhe u
jep mendje njerëzve të thjeshtë."

Psalmet 119:130



Fund



Ky tregim nga Bibla na tregon për Perëndinë tonë të mrekullueshëm i cili na krijoi neve dhe që dëshiron që ne ta njohim Atë.

Perëndia e di që ne kemi bërë gjëra të këqija, të cilat Ai i quan mëkate. Dënimi për mëkatin është vdekja, por Perëndia ju do juve aq shumë sa që dërgoi Birin e Tij të vetëm, Jezusin, që të vdes në Kryq dhe të dënohet për mëkatet e juaj. Pastaj Jezusi u ringjall dhe u ngrit lartë në Qiell! Nëse beson në Jezusin dhe i kërkon Atij të t'i falë mëkatet e tua, Ai do ta bëjë atë! Ai do të vijë dhe do të jetojë në ty, dhe ti do të jetosh me Të përgjithmonë.

Nëse ti beson se kjo është e vërteta, drejtohu Perëndisë kështu: Jezus i dashur, unë besoj se Ti je Perëndia dhe që ke ardhë si njeri që të vdesësh për mëkatet e mia, dhe që Ti jeton prap. Të lutem eja në jetën time dhe fali mëkatet e mia në mënyrë që unë të kem jetë të re dhe një ditë të jem me Ty gjithmonë. Më ndihmo të të bindem Ty dhe të jetoj për Ty si fëmija i yt. Amen.

Lexo Biblën dhe bisedo me Perëndinë çdo ditë! Gjoni 3:16

